



**VENDIM**

**Nr. 83 Datë 04.11.2009**

**PËR**

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “TEODORI 2003” SH.P.K NE  
AKTIVTETIN E PRODHIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 13, 14 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.11.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “TEODORI 2003” sh.p.k., për t`u liçensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

**Dhe konstatoi se:**

Aplikimi plotëson plotësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licensimet në sektorin e energjisë elektrike të,

- **Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1)**
- **Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronesor (neni 9, pika 2)**
- **Dokumentacionit finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3)**
- **Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4)**

**Vendosi:**

1. Licensimin e shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC i Zall Bulqizes me fuqi 5.350 MW dhe HEC i Ternoves me fuqi 8.385 MW.
2. “TEODORI 2003” sh.p.k të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC i Zall Bulqizes dhe HEC i Ternoves sipas afatit të përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit.
3. Afati i vlefshmerise se licenses të jetë 30 vjet.
4. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.